




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të Vendimit të Kryetarit të Komunës të datës 12.03.2020, lidhur me masat preventive të pandemisë së COVID-19, Komisioni ad-hoc referuar në situatën e krijuar mori këtë:

#### VENDIM

- Të procedohet urgjent me masat e dezinfektimit të vendeve publike, shkollave, sallave sportive, bus stacioneve dhe QKMF,QMF dhe AMF, objekteve fetare dhe vendeve tjera publike sipas kërkesës së komisionit.
- Urdhërohen kompanitë e transportit publik për ndermarrjen e masave për dezinfektimin e automjeteve për transport publik.
- QKMF të pajiset me të gjitha mjetet e udhëzuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë
- Të ndalohen me vendim deri në një vendimarrje tjetër tubimet publike, si ndeshjet sportive( pa publik), aktivitetet tjera kulturore e sportive.
- Të shpërndahen Udhezimet edhe fizike edhe elektronike në të gjitha rrjetet sociale zyrtare dhe lokale për mbrojtje preventive ndaj COVID-19.
- Bizneset hoteliere, kafiterit, restorantet, qebaptore, ëmbeltoret (të gjitha bizneset e hotelieris) të kufizohen dhe njoftohen me vendim nga Inspektorati që mund të punojnë deri në ora 23:00.
- Urdhërohen të gjitha drejtoritë komunale të pezullojnë takimet me palë përveç takimve që vlerësohen të natyres urgjente.
- Urdhërohen drejtoritë përkatse që të mos leshojnë leje apo pëlqime për tubime, evenimente apo promovime të tjera publike.
- Ligji i duhanit të respektohet strikt në të gjitha ambientet publike.
- Të Urdhërohen të gjitha institucionet publike të pajisen me dezinfektues për duar në hyrje të objekteve publike.
- Urdhërohen të gjitha bizneset të pajisen me dezinfektues për duar në hyrje të objekteve të biznesit.
- Inspektorati komunal të mbikqyrë çmimet në treg të produkteve ushqimore dhe produkteve tjera.
- Të kërkohet nga qytetarët t'i shmangen tubimeve publike dhe daljeve në ambiente të frekuentura, pa panik por me qëllim të masave preventive qytetarët dhe bizneseve të përfillin rekomandimet e Ministris të Shëndetësisë dhe Institutit Kombëtar të Shëndetësisë.

1Nr. 500-16167  
Lipjan, më 12.02.2020

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

